



BLINKEN NË TIRANË, HASANI: PARTNERITETI SHQIPËRI-SHBA SA VJEN EDHE FORCOHET MË SHUMË

MEPJ Igli Hasani mikpritri në Tiranë Sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken. Dy zyrtarët firmosën Memorandumin e Mirëkuptimit Kundër Manipulimit të Informacionit të Shtetit të Huaj (dezinformimit) si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright.



SHQIPËRIA E VENDOSUR NË PËRPEKJET PËR RIVENDOSJEN E INTEGRITETIT TERRITORIAL TË UKRAINËS

Në takimin e tij me MPJ e Ukrainës, Ministri Igli Hasani theksoi vendosmërinë e Shqipërisë për të vijuar përpjekjet për rivendosjen e integritetit territorial, sovranitetit, pavarësisë dhe lirisë së Ukrainës, si edhe për ta mbajtur Rusinë përgjegjëse për krimet e kryera në Ukrainë.



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA SHQIPËRI-ITALI PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Gjatë vizitës në Itali, MEPJ Igli Hasani mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të grupit “Miq të Ballkanit Perëndimor” dhe MPJ-ve të BP, ku theksoi nevojën për një qasje të re ndaj rajonit me fokus të veçantë në ekonomi. Gjithashtu, gjatë kësaj vizite, Ministri Hasani dhe homologu italian MPJ Antonio Tajani nënshkruan marrëveshjen për Sigurimet Shoqërore.



SHQIPËRI-INDI, ANGAZHIM I PËRBASHKËT PËRAVANCIMIN E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE

MEPJ Igli Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare në Indi ku u prit nga MPJ i Indisë, Subrahmanyam Jaishankar. Gjatë vizitës së tij, Ministri Hasani mori pjesë në edicionin e nëntë të “Dialogut Raisina”, zhvilloi takime sipërmarrës indianë dhe shqiptarë ku u diskutua rreth mundësive për biznes që ofron Shqipëria, si dhe një sërë takimesh tjera dypalëshe. Sipas tij, India përbën një vend me shumë potencial për Shqipërinë dhe forcimi i aleancës mes dy vendeve konsiderohet me interes të lartë, në aspektin ekonomik dhe gjeostrategjik.



SHQIPËRIA MERR MANDATIN NË KDNJ: PËR NJË BOTË KU ÇDO NJERI TË JETOJË ME DINJITET E RESPEKT

MEPJ Igli Hasani, gjatë fjalës në Segmentin e Nivelit të Lartë të KDNJ që u mbajt në Gjenevë, theksoi angazhimin e Shqipërisë ndaj parimeve të përjetshme të drejtave dhe dinjitetit të njeriut e për ndërtimin e një bote, ku çdo person mund të realizojë potencialin e tij të plotë dhe të jetojë me dinjitet dhe respekt. Gjatë takimit të posaçëm të mbajtur në Gjenevë, Ministri Hasani, mbajti deklaratën në emër të “Grupit të Miqve të Përgjegjshmërisë” për agresionin ndaj Ukrainës.



MINISTRI HASANI: REALIZUAM ME SUKSES NJË NGA DETYRAT MË KËRKUESE NË POLITIKËN E JASHTME

MEPJ organizoi takimin përmbyllës “Shqipëria në Këshillin e Sigurimit, kontribut për paqen dhe sigurinë globale gjatë kohërave më sfiduese”, gjatë së cilës Ministri Igli Hasani theksoi se Shqipëria realizoi me sukses një nga detyrat më të kërkuara në politikën e jashtme, duke rritur ndjeshëm profilin dhe imazhin e saj në arenën ndërkombëtare.



MINISTRI HASANI TAKIME DYPALËSHE NË MYNIH: NË FOKUS RRUGËTIMI EUROPIAN I SHQIPËRIË

MEPJ Igli Hasani gjatë pjesëmarrjes në Konferencën e 60-të Sigurisë së Mynihut, ka zhvilluar një sërë takimesh dypalëshe me homologë nga Kosova, Franca, Gjermania, Bullgaria, Kroacia, Sllovenia, Malta, Bavaria, Moldavia, Gjeorgjia, Azerbajxhani etj. Në fokus të takimeve ishin çështje si: situata aktuale e sigurisë evropiane dhe globale, thellimi i marrëdhënieve dypalëshe, integrimi evropian i rajonit të Ballkanit Perëndimor etj.